



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.491/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “FAICO” Sh.P.K., me seli në Prishtinë Fushë-Kosovë, me numër unik identifikues të regjistrimit të biznesit NUI:811436684, e përfaqësuar A.H., në cilësi të Drejtorit të përgjithshëm, me përfaqësues të autorizuar V.K. Avokat nga Prishtina, me kërkesëpadi për anulimin e vendimit 5961/01-KOM të datës 09.10.2023 të nxjerrë nga e paditura Komisioni për shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe vendimit të ARBK-së 569 të datës 29.08.2023, pas mbajtjes se seancës së shqyrtimit kryesor me datë 16.02.2024 më datë 13.03.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadija e paditësit “FAICO” Sh.P.K., me seli në Prishtinë Fushë-Kosovë, me numër unik identifikues të regjistrimit të biznesit NUI:811436684.
- II. ANULOHET vendimit me shifrën 5961/01-KOM i datës 09.10.2023 i nxjerrë nga e paditura Komisioni për shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe vendimit i ARBK-së me shifrën 569 të datës 29.08.2023.
- III. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.
- IV. Mbetet në fuqi shtyrja e ekzekutimi të vendimit me shifrën 5961/01-KOM i datës 09.10.2023 i nxjerrë nga e paditura Komisioni për shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe vendimit i ARBK-së me shifrën 569 të datës 29.08.2023, deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi.
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 01.11.2023 paditësi “FAICO” Sh.P.K., me seli në Prishtinë Fushë-Kosovë, me numër unik identifikues të regjistrimit të biznesit NUI:811436684, e përfaqësuar A.H., në cilësi të Drejtorit të përgjithshëm, ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit 5961/01-KOM të datës 09.10.2023 të nxjerrë nga e paditura Komisioni për shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe vendimit të ARBK-së 569 të datës 29.08.2023 si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të kundërshtuara.
2. Gjykata me Aktvendim të datës 02.11.2023 ka caktuar masësn e shtyerjes së ekzekutimi të vendimit me shifrën 5961/01-KOM i datës 09.10.2023 i nxjerrë nga e paditura Komisioni për shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe vendimit i ARBK-së me shifrën 569 të datës 29.08.2023, deri ne vendosjen e kërkesëpadisë me vendim gjyqësor.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik, më datë 16.02.2023 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokat B.K., sipas autorizimit të datës 16.02.2024, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt, e paditura ftesën e ka pranuar më datë 26.01.2024, prandaj seanca u mbajt në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur konform nenit 41 të LPK-së.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, gjatë shqyrtimin kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se edhe me tutje mbesin pranë padisë dhe kërkesëpadisë me të cilën kanë kërkuar anulimin e vendimeve të kundërshtuara me arsyetim se paditësi nga viti 2020 është regjistruar si SH.P.K. ne mënyrë të ligjshme ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve te Kosovës. Aksionarët e paditësit të janë dy shtetas te Republikës se Kosovës dhe te dyte te regjistruar ne Informatat e Biznesit te Shoqërisë, pranë Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve te Kosovës, si shtetas te Republikës se Kosovës, me letërnjoftime te Republikës se Kosovës, përkatësisht

A.H. me numër personal: ..., me adrese banimi ne Gjakove, rr. Skënderbeu nr. 112/2 dhe B.D. me numër personal: ... dhe me adrese banimi ne Rozhaje, Klekovacka, ne Malin e Zi.

5. Me date 29.08.2023 zv. Drejtoresha e Përgjithshme e ARBK-se, nxjerr Vendim per Shfuqizimin e Certifikatës së Biznesit te Shoqërise "FAICO" LIC, mbi pretendimin që z. B.D. është regjistruar me pasaporte te Malit te Zi, si Aksionar i Shoqërisë Faico LLC dhe se ne atë pasaporte, ka përmbajtte jo-kushtetuese te cilat cenojnë sigurinë publike te Republikës se Kosovës. Padihtësi ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankesë ne Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave pranë Ministrisë se Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësish me pretendim se shfuqizimi i Certifikatës se Biznesit te FAICO LIC, është lëshuar mbi bazën e vërtetimit te gabuar te gjendjes faktike, sepse z. B.D. është i regjistruar si Aksionar me letërnjoftim te Republikës se Kosovës, e jo me atë te Malit te Zi. Ndërkaq, vendbanimin e ka te regjistruar ne Rozhaje. Komisioni i Ankesave me Vendimin e Shkalles se Dyte, me numër 5961/01-KOM të datës 09.10.2023 refuzon Ankesën kundër Vendimit të shkalles se parë dhe e lenë ne fuqi Vendimin e shkalles se pare. Konsideron se Vendimi i Ankimuar është nxjerrur në gabim te zbatimit te se drejtës materiale dhe është Akt Administrativ i Paligjshëm sipas Nenit 52 par. 1.2., te Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Zv. Drejtoresha e Përgjithshme e ARBK, nuk ka kompetence për të nxjerrë Vendimin e ankimuar, përkatësisht Nenit 10 te Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, paragrafi 4 i këtij Neni thekson i përcakton kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK-së. Prandaj konsideron se Drejtori i Përgjithshëm i ARBK (ne këtë rast, zv. Drejtoresha e Përgjithshme e ARBK), nuk ka të drejtë qe te vendose kërkesa, kushte ose kufizime qe nuk janë te përcaktuara shprehimisht me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Prandaj, duke qene se Ligi per Shoqërite Tregtate, nuk përcaktohet shprehimisht kompetenca e Drejtorit te ARBK-se te nxjerre vendime per shfuqizimin e certifikatës se biznesit, e cila është mase ekuivalente me shuarjen dhe çregjistrimin e biznesit. Rrjedhimisht, Vendimi i Ankimuar është nxjerrë ne kundërshtim me Nenin 10 te Ligjit për Shoqëri Tregtare, nga organi jo-kompetent ne kundërshtim me Nenin 52 te Ligjit për Procedurën Administrative.
6. Me tutje deklaron se sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare ne nenin 45 paragrafi 4 dhe nenin 112 te ligjit, përcakton se shoqëria tregtare e organizuar ne forme te korporatës si ne rastin e Ankuesit, mund te shpërbehet ne rast te i) shpërbërjes vullnetare pas vendimit te miratuar nga

aksionaret e shoqërisë dhe ii) si rezultat i likuidimit të detyrueshëm në rastet e falimentimit të shoqërisë në procedurën e falimentimit para gjykatës kompetente.

7. Përveç kësaj, deklaron se personi juridik mund të shpërbehet sipas nenit 8 paragrafi 2 dhe nenit 11 të Ligjit nr. 04/L-030 "Për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale" si pjesë e sanksionit të vendosur nga gjykata në procedurë penale për shkak të përgjegjësisë penale të personit juridik për kryerjen e veprave penale.
8. Edhe po të kishte fushëveprim në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), Vendimi i ankimuar është në kundërshtim me Parimin e ligjshmërisë sipas LPPA, sipas Neni 4, paragrafi 2, i LPPA-së përcakton që veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj. Prandaj sipas nenit sipas Neni 52 par. 1, pika 1.1, vendimi i kundërshtuar konsiderohet i kundërligjshëm. Po ashtu konsideron se Vendimi i ankimuar është në kundërshtim me Parimin e Proporcionaliteti, sepse edhe nëse pasaporta e aksionarit do të ishte në kundërshtim me ndonjë Ligj, ARBK do të mund të i jepte një afat Ankuesit për të përmirësuar detajet dhe të dhënat e Aksionarit, e jo të merrte masën aq drastike duke shfuqizuar Certifikatën e Biznesit. Konsideron që ky Vendim është i paligjshëm, sipas Neni 52 par. 1, pika 1.7 të LPPA-së dhe në kundërshtim me nenin 9 të LPPA-së, Parimin e Administratës së Hapur. Prandaj i propozon gjykatës të aprovoj si të bazuar padinë dhe të anuloj vendimet e kundërshtuara si të kundërligjshme sepse janë nxjerrë me një sërë shkeljesh procedurave të LPA-së pasi paditësi nuk është thirrë të deklarohet në asnjë moment gjatë procedurës administrative të zhvilluar kundër tij, në kundërshtim me parimin e transparencës si dhe kundërshtim me parimin e ligjshmërisë pasi veprimet e organit të paditur nuk janë të bazuara me ligj, të normuara me LPA-së.

Kundërshtimet e të paditurës

9. E paditura ARBK në Ministrinë e Industrisë, Ndermarresisë dhe Tregtisë e përfaqësuar nga, nga Avokatura Shtetërore, përfaqësuese ligjore e të Paditurës, në përgjigje në padi të parashtruar me datë, 23.01.2024, ka theksuar se e paditura e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, si ta pabazuar në prova, deklaron se vendimi i atakuar është marrë konform dispozitave ligjore dhe në mënyrë të drejtë, andaj i propozon gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë si të pabazuar. Përgjigjes në padi nuk ia ka bashkangjitur provat. Po ashtu në seancë të shqyrtimit kryesor

përfaqësuesja e të paditurës e ftuar në mënyrë të rregullt nuk përfaqëson, për seancë deklarohet me parashtrësë të datës 08.02.2024 ku thekson se e paditura e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, si ta pabazuar në prova, deklaron se vendimi i atakuar është marrë konform dispozitave ligjore dhe në mënyrë të drejtë, dhe i propozon gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë si të pabazuar.

Provat e administruara

10. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Informatat mbi biznesin e paditësit FAICO Shpk me nr. unik 811436684; Vendimi i ARBK me nr.659 datë 29.08.2023; Ankesa e paditësit kundër këtij vendimi me datë 26.09.2023 e plotësuar me datë 01.10.2023; Vendim i komisionit për shqyrtimin e ankesave për regjistrimin e bizneseve me nr.5961/01-KOM me datë 09.10.2023; Lista e qiramarrësve të Central Park; Qarkullimi bankar nga llogaria e paditësit FAICO sh.p.k për periudhën 01.04.2023 deri me 26.10.2023 nga Raiffeisen Bank, Qarkullimi bankar nga llogaria e paditësit FAICO shpk për periudhën 01.04.2023 deri me 26.10.2023 nga NLB Bank, Formularët e deklarimit të tvsh-së në ATK nga 04.2023 deri me 09.2023, Kontratë dhe aneks kontratë në mes të paditësit si qiradhënës dhe palëve të treta si qiramarrës, Pasqyrat financiare të paditësit dhe raporti i auditorit të pavarur të datës 31.12.2022, Konfirmim i marrëveshjes së kredisë i datës 26.10.2023 nga Raiffeisen Bank, Kontrata për realizimin e punëve ndërtimore e kontraktuar nga paditësi me fotografi të bashkangjitura, Lista e pagave nga ATK, Ekstrakt i regjistrimit të biznesit të subjektit FAICO solar sh.p.k nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë –Republika e Shqipërisë, Ekstrakt i regjistrimit të biznesit të subjektit EKS Energy sh.p.k nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë –Republika e Shqipërisë me dokumentet e bashkangjitura.

11. Me Vendimin Nr. 659, date:29.08.2023 Agjencioni i Regjistrimit te Bizneseve ne Kosove (ARBK) në Ministrinë e Industrisë, Ndermarresise dhe Tregtisë (ARBK) ka shfuqizuar Çertifikatën e Regjistrimit te Biznesit "FAICO" sh.p.k. me NUI:811436684 me adrese ne Prishtine dhe ka obliguar Shoqërinë Tregtare "FAICO" sh.p.k. me NUI:811436684, që brenda 5 ditësh nga dita kur ky vendim behet i plotfuqishëm, te dorëzoj ne ARBK, çertifikatën origjinale të regjistrimit, me arsyetim se paditësi "FAICO" sh.p.k. me NUI:811436684, me date 10.07.2020, ka parashtruar kërkesë në ARBK për regjistrim te biznesit, për ushtrimin e aktivitetit kryesor te biznesit: Qiradhënia dhe menaxhimi i patundshmërisë personale ose te

marra me qira dhe aktivitete te tjera te ngjashme. Ministria e Industrisë, Ndermarrësisë dhe Tregtisë (MINT), me Vendimin nr.4009/02 te dates 06.07.2023 ka themeluar komisionin për ri-verifikimin e dosjeve ne ARBK. Raportit te Komisionit nr. 4427/02 me datë 21.07.2023, konstaton se ne dosjen e Shoqërisë Tregtare "FAICO" sh.p.k. me NUI:811436684, rezulton qe me datën 13.10.2020 aplikuesi A.H. ka bere kërkesë për shtim te aksionareve, me anë te kontratës për faljen e aksioneve 30% e aksioneve te kompanisë, janë bartur tek B.D. i cili ka prezantuar dokumentin identifikues/ pasaportën me nr. ... e lëshuar nga autoritetet e Republikës se Malit te Zi ne emër te B.D. (pronar/ aksionar i shoqërisë tregtare), ku ne rubrikën: vendi i lindjes është shkruar "Pec, SRB". Gjithashtu me date 29.10.2020, Shoqëria Tregtare "FAICO" sh.p.k. me NUI:811436684 përmes aplikuesit A.H. ka bëre kërkesë për ndryshim/rritje kapitali, ku edhe në këtë rast është prezantuar dokumentin identifikues/pasaportën me nr. ... e lëshuar nga autoritetet e Republikës se Malit te Zi ne emër te B.D. (pronar/ aksionar i shoqërisë tregtare), ku ne rubrikën: vendi i lindjes është shkruar "Pec, SRB". Përmbajtjet e tilla, nuk lejohet te përdoren ne Republikën e Kosovës, për shkak se emërtimi i përdorur për vend lindjen dhe shtetin, ka shkaktuar shkelje te normave kushtetuese dhe një veprim i tille, paraqet kërcënim serioz ndaj sigurisë publike te përcaktuar me nenin 57 dhe 58 te LPPA-së (Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative).

Vlerësimi i gjykatës

12. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.
13. Nga provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: paditësi "Faico" SH.P.K është regjistruar si biznes në ARBK, me datë 10.07.2020, me Numer Unik Identifikues 811436684, për të ushtruar aktivitetin kryesor qiradhënje dhe menaxhim te patundshmërisë personale ose të marra me qira, aktivitet sekondar tregti me shumicë jo e specializuar dhe aktivitete të tjera. Sipas informatave mbi biznesin pronar të "Faico" SH.P.K janë: A.H., me numer personal ... me adresë në Rr. Skënderbeu, Nr, 112/2 Gjakovë, Kosovë dhe B.D., me nr. personal ..., me adresë në "Klekovaçka" nr.3, Rozhajë, Mali i Zi. Pronari B.D., është i regjistruar me

letërnjoftim të Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit ..., të lëshuar me datë 08.05.2017, me adresë të vendbanimit Pejë, me nr. personal

14. E paditura Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) në Ministrinë e Industrisë, Ndermarrësisë dhe Tregtisë (ARBK) me Vendimin Nr. 659, datë:29.08.2023 ka shfuqizuar Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit "FAICO" SH.P.K. me NUI:811436684 me adresë në Prishtinë dhe ka obliguar Shoqërinë Tregtare "FAICO" sh.p.k. me NUI:811436684, që brenda 5 ditësh nga dita kur ky vendim bëhet i plotfuqishëm, të dorëzojë në ARBK, çertifikatën origjinale të regjistrimit, me arsyetim se paditësi "FAICO" sh.p.k. me NUI:811436684, me datë 10.07.2020, ka parashtruar kërkesë në ARBK për regjistrim të biznesit, për ushtrimin e aktivitetit kryesor të biznesit: Qiradhënia dhe menaxhimi i patundshmërisë personale ose të marra me qira dhe aktivitete të tjera të ngjashme, Ministria e Industrisë, Ndermarrësisë dhe Tregtisë (MINT), me Vendimin nr.4009/02 të datës 06.07.2023 ka themeluar komisionin për ri-verifikimin e dosjeve në ARBK.
15. E paditura ka vlerësuar se në dosjen e Shoqërisë Tregtare "FAICO" sh.p.k. me NUI:811436684, nga të gjeturat e Raportit të Komisionit nr. 4427/02 me datë 21.07.2023, rezulton që me datën 13.10.2020 aplikuesi A.H. ka bërë kërkesë për shtim të aksionareve, me anë të kontratës për faljen e aksioneve 30% e aksioneve të kompanisë, janë bartur tek B.D. i cili ka prezantuar dokumentin identifikues/ pasaportën me nr. ... e lëshuar nga autoritetet e Republikës së Malit të Zi në emër të B.D. (pronar/ aksionar i shoqërisë tregtare), ku në rubrikën: vendi i lindjes është shkruar "Pec, SRB". Gjithashtu me datë 29.10.2020, Shoqëria Tregtare "FAICO" sh.p.k. me NUI:811436684 përmes aplikuesit A.H. ka bërë kërkesë për ndryshim/rritje kapitali, ku edhe në këtë rast është prezantuar dokumentin identifikues/pasaportën me nr. ... e lëshuar nga autoritetet e Republikës së Malit të Zi në emër të B.D. (pronar/ aksionar i shoqërisë tregtare), ku në rubrikën: vendi i lindjes është shkruar "Pec, SRB".
16. Ndaj këtij vendimi, paditësi "FAICO" SH.P.K. me NUI:811436684, me datë 26.09.2023 ka parashtruar ankesë, të plotësuar me datë 01.10.2023, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material, zbatimi jo të drejtë dhe të gabuar të procedurës dhe vërtetimi jo të plotë dhe i gabuar të gjendjes faktike, me arsyetim se asnjë herë nuk e ka pranuar Raportin e Komisionit nr. 4427/02 me datë 21.07.2023, përveç vendimit të zv. Drejtoreshës së ARBK-së të datës 29.08.2023, me të cilën shfuqizohet certifikata e biznesit. Përveç të tjerash në ankesë, ankuesi

e kundërshton kompetencën e zv. Drejtoreshës së ARBK-së për interpretimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës edhe kompetencën për shfuqizimin e certifikatës së biznesit.

17. Me Vendim të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve me nr.5961/01-KOM me datë 09.10.2023, refuzohet ankesa dhe mbete ne fuqi vendimi me numër 659 datë 29.08.2023, me arsyetim se Shoqëria Tregtare "FAICO" sh.p.k. të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga pala, e ka paraqitur adresën e banimit në Rozhajë, dhe ka bashkangjitur kopjen e pasaportës me nr. ..., ku vendi i lindjes shënon "PEC-SRB". Me tutje thekson se ndryshimi i të dhënave të biznesit është bërë përmes aplikimit online, e cila forme lejon qasje që vet aplikuesi të bëjë ndryshimin e të dhënave dhe më këtë rast është paraqitur dokumenti me nr. ..., ku vendi i lindjes shënon "PEC-SRB".

18. Gjykata i vlerëson të pabazuara pretendimet e paditësit lidhur me autorizimet dhe kompetencën të paditurës që të shfuqizoj certifikatën e një biznesi sipas Nenit 10 i Ligjit për Shoqëri Tregtare.

19. Se pari gjykata ri kujton se rregullimi i procesit të regjistrimit përfshirë ndryshimet tjera të të dhënave ekzistuese bie në funksionin dhe kompetencën e ARBK-së rregullat e të cilës janë të detyrueshme për shoqëritë tregtare të përcaktuar me nenin 9, ku përcaktohet se: *1. ARBK bën regjistrimin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë, si dhe është e autorizuar për kryerjen e funksioneve të tjera të përcaktuara me këtë Ligj apo funksioneve që i janë caktuar ARBK me ligje të tjera dhe Nenit 10 paragrafi 4 të LSHT-së, ku përcaktohet se: Drejtori i Përgjithshëm i ARBK ushtron kompetenca drejtuese dhe nxjerr vendime dhe udhëzime të tjera të detyrueshme për rregullimin e procesit të regjistrimit të Shoqërive Tregtare për qendrat e regjistrimit në pajtim të plotë me këtë ligj. Shprehimisht përcaktohet se vendimet dhe udhëzimet e nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i ARBK sipas këtij ligji nuk do të vendosin kërkesa, kushte ose kufizime që nuk janë përcaktuar shprehimisht me këtë ligj.*

20. Mënyra e ndryshimeve të dhënave ekzistuese në Regjistër bëhet sipas aplikimit të Shoqërisë Tregtare, dhe rregullohet konform nenit 17 ku përcaktohet se: *1 ARBK-ja nuk ka të drejtë të refuzojë regjistrimin fillestar, regjistrimet tjera dhe ndryshimin dhe plotësimin në e të dhënave ekzistuese nëse dorëzohen të gjitha dokumentet që kërkohen me ligj dhe nëse ato janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji apo ligjeve të tjera në fuqi dhe 3. Aplikimi nga Shoqëria Tregtare duhet të përcillet me dokumente që përbëjnë bazën për regjistrim në Regjistër.*

Dokumenti i dorëzuar në ARBK duhet të përmbajë informatat e përcaktuara me këtë ligj dhe ligje të tjera në fuqi.

21. Prandaj gjykata vlerëson se janë ta pabazuara pretendimet që i referohen kompetencës së ARBK-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK-së, sepse ARBK është institucion i vetëm në Republikën e Kosovës me përgjegjësi për regjistrimin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë, si dhe është e autorizuar për kryerjen e funksioneve të tjera të përcaktuara me këtë Ligj apo funksioneve që i janë caktuar ARBK me ligje të tjera (sipas nenit 9 të LSHT), dhe konform Nenit 17 paragrafi, 7. ***nëse ARBK vlerëson se aplikimi për regjistrim, çregjistrim apo ndryshim të dhënave në Regjistër nuk përmbush kërkesat e këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër në fuqi, si dhe për shkak të kësaj mos përmbushjeje,[...] njofton Përfaqësuesin e Autorizuar ose Përfaqësuesin me Prokurë për këtë fakt, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si dhe cakton një afat jo më të gjatë se dhjetë (10) ditë pune për korrigjimin e mangësisë(ve). Nëse këto mangësi nuk korrigjohen deri në fund të afatit, ARBK-ja mund të refuzojë përmbylljen e aplikimit.***
22. Nga interpretimi i dispozitave ligjore të cituara më lart, rezulton se me rastin a aplikimit për regjistrim rrjedh detyrimi i Shoqërive Tregtare ti përmbahen rregullave të detyrueshme për shoqëritë tregtare, që regjistrimet dhe ndryshimin dhe plotësimin në e të dhënave ekzistuese të mbështeten me dokumente që përbëjnë bazën për regjistrim në Regjistër dhe përmbajnë informata në pajtim me këtë ligj dhe ligjet e tjera në fuqi.
23. Gjykata e vlerëson jo kontestues arsyetimin e dhënë nga e paditura se Shoqëria Tregtare "FAICO" sh.p.k. se në të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga pala, i njejtë e ka paraqitur adresën e banimit në Rozhajë, dhe ka bashkangjitur kopjen e pasaportës me nr. ..., ku vendi i lindjes shënon "PEC-SRB", këtë fakt e ka konfirmuar si të vërtetë edhe vet paditësi në ankesë të datës 26.09.2023 në të cilën ka deklaruar se kërkesës për hapje të biznesit ia ka bashkangjitur dokumentet identifikuese të aksionarëve dhe pasaportën e njërit nga aksionareve B.D., shtetas i Republikës së Malit të Zi, me pasaportë nr.
24. Në këtë rast shtrohet pyetja se informatat qe përmban dokumenti kontestues: pasaporta me nr. ... e lëshuar nga autoritetet e Republikës se Malit te Zi ne emër te B.D. (pronar/ aksionar i

shoqërisë tregtare), ku ne rubrikën: vendi i lindjes është shkruar "Pec, SRB"- a është në kundërshtim me këtë ligj apo ligjet e tjera në fuqi?

25. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 12 [Pushteti Lokal] përcakton: Njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat.

26. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale me parimet e përgjithshme të përcaktuara me Neni 4 par .1, përcakton: *Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore. Po i njëjti ligj në Nenin 6, përcakton Emrat dhe Kufijtë: *Komunat kanë emrat dhe kufijtë e tyre, siç përshkruhet në Ligjin për Kufijtë administrativ të Komunave dhe mund të ndryshohen vetëm në përputhje me atë ligj.**

27. Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave rregullon organizimi territorial të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës, përcaktohet territori i komunës si njësi e vetëqeverisjes lokale, përcaktohen kufijtë administrativ komunal, emrat dhe selitë e komunave, [...] Neni 5.1 përcakton që *Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, pika 15. Komuna e Pejës me seli në Pejë.*

28. Prandaj, në kuptim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, Gjykata vlerëson se përmbajtja dokumentit/pasaporta me nr. ... e lëshuar nga autoritetet e Republikës së Malit të Zi në emër të B.D. (pronar/ aksionar i shoqërisë tregtare), ku ne rubrikën: vendi i lindjes - Komuna e Komuna e Pejës paraqitet me seli në Republikën e Serbis, "Pec, SRB"- është në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore të cituara më lart.

29. Gjykata ri kujton se kërkesat ligjore për Regjistrimi fillestar dhe ndryshimi i të dhënave të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar janë të detyrueshme për shoqërite tregtare, kjo çështje definohet saktësisht në Nenin 33 të LSHT, ku përcaktohet: *Për regjistrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, Përfaqësuesi i Autorizuar ose Përfaqësuesi me Prokurë duhet të plotësojë dhe dorëzojë në ARBK: 1.1. formularin e përgatitur nga ARBK për këtë qëllim, duke përfshirë të dhënat vijuese: 1.1.1. emrat dhe adresat e Aksionarëve dhe Aksioneve të tyre në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar; 1.1.2. emrat dhe adresat e Drejtorëve Menaxhues dhe*

*Përfaqësuesve të tjerë të Autorizuar ose Përfaqësuesve me Prokurë sipas nenit 24 të këtij ligji, [...] 1.1.3. emrat dhe adresat e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka Bord të Drejtorëve. dhe 1.2. kopjen e dokumentit personal të identifikimit të Përfaqësuesit të Autorizuar; dhe me kërkesat e përcaktuara përmes Udhëzimit Administrativ(MINT) Nr. 01/2021 për Regjistrimin e Shoqërive Tregtare Neni 8 par. 1, ku përcaktohet: **Për Regjistrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, parashtruesi duhet të plotësojë dhe dorëzojë në ARBK: 1.1. Formularin përkatës për regjistrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; 1.2. Fotokopjen e dokumentit personal të identifikimit të Themeluesve si dhe Përfaqësuesit të Autorizuar ose Përfaqësuesit me Prokurë – nëse Aksionari është shtetas i huaj atëherë fotokopja e pasaportës; kur aksionar është një Shoqëri Tregtare, certifikata e regjistrimit në Kosovë, nëse themelues është Shoqëria e Huaj Tregtare, certifikata e regjistrimit dhe informatat e biznesit jo më të vjetra se tre (3) muaj;***

30. Po ashtu Neni 17 paragrafi 8 i LSHT-së, përcakton detyrimin që: Çdo Shoqëri Tregtare është e obliguar të përditësojë të dhënat e regjistruara në Regjistër, si dhe të sigurojë saktësinë e tyre të përhershme dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e këtij ligji. Ndryshimi i të dhënave nga ato të regjistruara duhet të paraqitet në ARBK brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data kur ka ndodhur ndryshimi përkatës.

31. Gjykata vlerëson se aplikimi/ndryshimi i të dhënave të biznesit është bërë përmes aplikimit online, e cila formë lejon qasje që vet aplikuesi të bëjë ndryshimin e të dhënave dhe më këtë rast është paraqitur dokumenti me nr. ..., ku vendi i lindjes shënon “PEC-SRB”. Prandaj e paditura ARBK në Ministrinë e Industrisë, Ndermarrësise dhe Tregtise (MINT), konform autorizimeve dhe përgjegjësive ligjore për vërtetimin e saktësisë së të dhënave (nenit 21 të LSHT), me Vendimin nr.4009/02 te datës 06.07.2023 ka themeluar Komisionin për ri-verifikimin e dosjeve ne ARBK, dhe është ligjërisht e autorizuar që të korrigjoj gabimet çoftë edhe me revokim/shfuqizim të certifikatës së regjistrimit e cila, i cili revokim/shfuqizim nuk nënkupton në asnjë mënyrë shpërbërje të SH.P.K-së apo falimentim në kuptim Nenin 112 të LSHT dhe as pushim të personit juridik sipas Ligji Nr. 04/L-030 për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale, por është i barasvlershëm me refuzim të regjistrimit sepse kemi të bëjmë me kërkesa formale të regjistrimit që janë të detyrueshme në secilin juridiksion te secilit shtetet. Pra janë kërkesa strikte formale dhe në këtë rast nuk kemi të bëjmë me natyrën e shoqërisë sipas Neni 78 të LSHT, në raport me përgjegjësinë e ndarë të Shoqërisë me

Përgjegjësi të Kufizuar si person juridik nga aksionarët, sepse përgjegjësia i referohet të drejtave dhe detyrimeve që merr përsipër SHPK në ushtrimin veprimtarisë ekonomike, siç janë: të ushtrojë padi ose të jetë e paditur, të lidh kontrata, të marrë borxhe apo të krijojë detyrime etj. Ndërsa kërkesat e regjistrimit janë formale dhe të gjitha dokumentet përfshirë përmbajtjen e tyre duhet të jenë në përputhje me parimet kushtetuese dhe ligjet në fuqi.

32. Neni 17 paragrafi 7 i LSHT-se e autorizon ARBK të: *vlerësoj nëse aplikimi për regjistrim, çregjistrim apo ndryshim të dhënave në Regjistër i përmbush kërkesat e këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër në fuqi, si dhe përcakton se për shkak të kësaj mos përmbushjeje,[...] ARBK njofton Përfaqësuesin e Autorizuar ose Përfaqësuesin me Prokurë për këtë fakt, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si dhe cakton një afat jo më të gjatë se dhjetë (10) ditë pune për korrigjimin e mangësisë(ve). Nëse këto mangësi nuk korrigjohen deri në fund të afatit, ARBK-ja mund të refuzojë përmbajtjen e aplikimit.*

33. Po ashtu, LSHT Neni 21 paragrafi 1, përcakton që ARBK mund t'i korrigjojë gabimet në çdo kohë....[...] 3. *Nëse ARBK-ja ka informata në lidhje me pasaktësinë e një të dhëne të regjistruar apo që një e dhënë mungon, ARBK bën kërkimet e duhura. 4. Pas vërtetimit që të dhënat në Regjistër janë të pasakta apo mungojnë, ARBK-ja njofton Shoqërinë Tregtare në aplikimin e së cilës duhet bërë regjistrimi. Nëse nuk ka kundërshtim ndaj regjistrimit apo korrigjimit të informatave brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas atij njoftimi, ARBK-ja bën regjistrimin apo korrigjon të dhënat. Pas pranimit të kundërshtimit, ARBK-ja vendos nëse ai kundërshtim ka bazë. paragrafi 6 përcakton Nëse dorëzohen informata të pasakta në ARBK, Shoqëria Tregtare dhe Përfaqësuesi i Autorizuar ose Përfaqësuesi me Prokurë që kanë dorëzuar dokumentet në ARBK mbajnë përgjegjësi për dëmet që mund të jenë shkaktuar me keqdashje.*

34. Mirëpo, Gjykata e vlerëson të bazuar pretendimin e paditësit “Faico” SH.P.K se e paditura asnjëherë në asnjë fazë të procedurës nuk e kishte njoftuar paditësin me përmbajtjen e Raportit të Komisionin për ri-verifikimin e dosjeve në ARBK me nr. 4427/02 të datës 21.07.2023, përveç se kur e paditura kishte marrë vendim 659 të datës 29.08.2023 për shfuqizim të certifikatë së biznesit.

35. Përveç që paditësit nuk i ishte dhënë mundësia të njoftohet me përmbajtjen e raportit të komisionit të njëjtit nuk i është dhënë mundësia për korrigjim. Përderisa, e paditura nuk e

konteston autenticitetin dhe vlefshmërinë e pasaportës me nr. ... të lëshuar nga autoritetet e Republikës së Malit të Zi në emër të B.D. (pronar/ aksionar i shoqërisë tregtare), por i referohet saktësisë së përshkrimit të Komunës së Pejës, ku në rubrikën: vendi i lindjes - Komuna e Komuna e Pejës paraqitet "Pec, SRB", e që nuk reflekton Komunën e Pejës si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale brenda kufijve administrativ të Republikës e Kosovës.

36. Gjykata vlerëson se vendimi i të paditurës për shfuqizimi të certifikatës së biznesit të paditësit pa i dhënë mundësinë e korigjimit, siç përcaktohet me Nenit 17 paragrafi, 7. është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe transparencës, sepse po që së e paditura ka vlerësuar se nuk përmbushen kërkesat e këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër në fuqi do duhej ta njoftonte paditësin dhe ti ipej një afat për korigjim.
37. Përveç kësaj, po që se korigjimi i të dhënave do të ishte i pamundur të realizohet me kërkesë personale të paditësit/aksionarit për shkak të praktikës/politikës së autoriteteve të Malit të Zi, kjo çështje do të duhej të afirmohej me marrëdhënie diplomatike midis dy shteteve. Sepse përgjithësisht në drejtën ndërkombëtare pas procesit të njohjes se pavarësisë së një shtetit nga një shtet tjetër pritet të ndryshohen dokumentet administrative duke përfshirë edhe referimet/përshkrimin e njësi themelore të vetëqeverisjes lokale brenda kufijve administrativ të shtetit të pavarur. Mirëpo, po që së pasaporta është lëshuar pas njohjes së pavarësisë së Shtetit të Kosovës nga shteti i Malit të Zi dhe nëse rezulton që edhe pas njohjes se pavarësisë përshkrimi i autoriteteve të Malit të Zi për qytet-in/et e Kosovës i referohet "Pec,SRB" kjo mund të rrjedhë si pasojë e çështjeve të trashëguara nga sistemi juridik dhe struktura administrative nga regjimi paraardhës. Prandaj, parimisht do të duhej të shqyrtohej vlefshmëria e këtyre dokumenteve me ligje dhe procese administrative apo nëpërmjet Marrëveshjeve bilaterale të qartësohet statusi dhe vlefshmëria e dokumenteve të lëshuara para njohjes se pavarësisë dhe ndryshimet që do të duhej të inkorporohen pas njohjes së pavarësisë, në mënyrë që veprimet e organeve publike të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave siç përcaktohet në Neni 8 të LPPA-së.
38. Prandaj, Gjykata vlerëson se e paditura ARBK ka vepruar në kundërshtim me Nenit 17 paragrafi, 7 të LSHT-së sepse nuk i ka dhënë mundësi paditësit që të njihet me vlerësimet e Raportit të Komisionin për ri-verifikimin e dosjeve në ARBK me nr. 4427/02 të datës 21.07.2023 dhe që brenda afatit të përcaktuar ligjorë ta njoftoj për mundësinë korigjimit të dhënave apo paraqitjes se kundërshtimit para se të marr vendim për shfuqizim të certifikatës së

biznesit, nga rezulton se e paditura në procedurë administrative ka vepruar në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe parimin e administratës së hapur të përcaktuar në Ligji (Nr. 05/L -031) për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), ngase përmes vendimit të marrë në kundërshtim me veprimet ligjore procedurale sipas nenit 17.7 të LSHT, vendim për shfuqizim të certifikatës së biznesit rezulton të jetë jo proporcional, sipas nenit 5 të LPPA-së, ku përcaktohet: *1. Një veprim administrativ, që për arsye të mbrojtjes së interesit publik kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personi, duhet të jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit. 2. Një veprim administrativ është në pajtim me parimin e proporcionalitetit vetëm nëse i plotëson këto kushte: 2.1. është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj; 2.2. është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, dhe 2.3. kufizimi apo cenimi i të drejtës apo interesit juridik nuk është në shpërpjesëtim me realizimin e qëllimit të ndjekur,* Nenin 8 ku përcaktohet se Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave, dhe nenit 9 të LPPA-së, ku përcaktohet se: *1. Organet publike duhet të veprojnë me transparencë. 2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj.*

39. Prandaj, vërtetohet se Vendimi i Komisionit për Regjistrimin e Bizneseve si organ i shkallës së dytë me nr.5961/01.KOM dhe vendimi i ARBK me nr.659 datë 29.08.2023 është nxjerrë në shkelje të dispozitave të LPPA-së, nenit 52 paragrafi, 1.3, që e bëjnë të paligjshëm aktin administrativ ku përcaktohet se: *1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative.* Gjykata i vlerësoj edhe provat e tjera kryesisht kontratat ne raportet juridike civile te paditësit por konstaton se këto prova nuk ishin me rëndësi për vlerësimin e ligjshmërisë se vendimit te kundërshtuar.

40. Bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të LKA, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë
Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.491/23, datë 13.03.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimi, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.